



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A.NR. 309/10**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Nehat Idrizi dhe Vlastimir Dimic, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Dragana Zdravkovic kandidate për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Srpska Socialdemokratska Stranka (SSDS) nga fshati Staro Gradsko-Lipjan, që ka të bëjë me tërheqjen nga lista e kandidateve, në seancën e mbajtur me datë 02.12.2010 mori këtë:

**VENDIM**

**HIDHET** poshtë apeli si i pasafatshëm

**ARSYETIM**

Dragana Zdravkovic kandidate për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik Srpska Socialdemokratska Stranka (SSDS) nga fshati Staro Gradsko-Lipjan, ka parashtruar apel për tërheqjen nga lista e kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Parashtruesja e apelit ka deklaruar se është e njoftuar se gjendet në listën e kandidatëve të subjektit politik SSDS dhe se për këtë kurrë nuk ka pranuar apo nënshkruar deklaratën për të qenë në këtë listë. Ajo shton se nëse figuron nënshkrimi i saj në atë dokument atëherë me përgjegjësi deklaron që është i falsifikuar ai nënshkrim.

Parashtruesja e apelit kërkon që PZAP-i të bëjë fshirjen e emrit të saj nga lista e kandidatëve të subjektit politik SSDS sepse sipas saj nuk mund të jetë kandidate se kjo do të ishte në kundërshtim me përshkrimin e vendit të saj të punës.

## FAKTET

PZAP ka pranuar një apel më datë 01.12.2010 nga Dragana Zdravkovic kandidate për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik (SSDS) nga fshati Staro Gradsko-Lipjan, e cila kërkon tërheqjen nga lista e kandidateve nga ky subjekt politik.

Parashtruesja e apelit ka pohuar që kandidimi i saj është bërë pa pranimin e saj.

## ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072).

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (Nr. 03/L-073),

Neni 122 pika c) LZP përcakton:

*Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilat janë prekur nga cilat do vendime të më poshtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apeloj atë vendim në PZAP brenda 24 orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli.*

*c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;*

Lista e kandidatëve konsiderohet të jetë e certifikuar nga KQZ-ja në kohën e tërheqjes së shortit më 20 nëntor 2010, në ora 17:00 ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë pas certifikimit gjë që nuk e ka bërë Kandidatja Dragana Zdravkovic nga SSDS-ja.

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se apeli është e pasafatshme, sepse apeli në PZAP është pranuar më datë 30.12.2010, ndërsa afati për parashtrim të apelit në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 309/2010 më datën 02.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

